



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 27.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

”PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.55/2015, “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 27.11.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të paraqitur dhe mbrojtur projektligjin, si dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Nga përmbajtja e projektligjit dhe relacionit shpjegues që shoqëron atë, qëllimi kryesor i projektligjit është mospërfitimi i mbështetjes dhe lehtësive të parashikuara nga ligji, nga investuesit, të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e disa veprave të rënda penale, por edhe në rastet kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë

është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda investuesit.

III. RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE DHE RIFORMULIME SIPAS NENEVE

Në përfundim të shqyrtimit dhe diskutimit të projektligjit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji, si dhe në miratimin në tërësi të projektligjit, miratoi dhe i përcjell komisionit përgjegjës këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 1/1 riformulohet si vijon:
“1/1. Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e veprës penale:
2. Me qëllim formulimin e qartë si dhe duke marrë parasysh në listimin e veprave penale përputhshmërinë me Kodin Penal, shkronjat “d” dhe “ë” të pikës 1/1 riformulohen si vijon:

“d)Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste”;
“ë) Shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.”
3. Në shkronjën “ë” që shtohet, togfjalëshi “vërtetim nga dosja gjyqësore” të zëvendësohet me togfjalëshin “vërtetim mbi gjendjen gjyqësore”.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

R E L A T O R

Edmond LEKA

K R Y E T A R

ULSI MANJA